

## ***Hilfu'l-Fuduli* dhe mesazhet e tij për ne sot**

### **Gjendja e përgjithshme**

Në Arabinë para-islame sundonte rendi fisnor si një sistem shoqëror, në të cilin fise të ndryshme, të mëdha e të vogla, lidhnin pakte e aleanca me njëri-tjetrin. Fiset që mbeteshin jashtë ndonjë aleance, u nënshtroheshin zakonisht sulmeve dhe grabitjeve të fiseve me të cilat nuk kishin aleanca të këtilla. Kjo ishte edhe arsyeja e luftërave që zgjatnin edhe me qindra vite.

Qyteti i Mekkes nuk ishte i kursyer nga këto luftëra, mirëpo meqë ishte në kryqëzimin e dy rrugëve të mëdha tregtare të Arabisë: *Rrugës së Hixhazit* e cila kalonte përgjatë bregut lindor të Detit të Kuq dhe lidhte Jemenin në jug me Shamin (Libanin, Sirinë, Jordaninë dhe Palestinën) në veri dhe *Rrugën e Nexhdit* që e lidhte Jemenin me Irakun<sup>1</sup>, për dallim prej qyteteve dhe vendbanimeve të tjera, kishte një vigjilencë dhe kujdes më të madh që këto të redukttoheshin në minimum. Një qytet të cilit i mungonin pasuritë natyrore dhe që ishte i lidhur me blegtorinë dhe më shumë me tregtinë e jashtme, ishte më se e nevojshme që të kishte një stabilitet dhe siguri politike.

“Qytetit të kurejshitëve (Mekkes), që sipas Kur’anit ndodhej në “një luginë, ku nuk ka bimë”<sup>2</sup>, i mungonin kulturat (bujqësore) dhe për të mbijetuar kishte nevojë për çfarëdo malli të importuar<sup>3</sup>. Nëse e shikojmë më mirë, me të kaluarën e tij beduine (endacake) populli kurejshit që zhvillonte një jetë shumë të gjallë, përgjithësisht kishte nevoja të vogla; mirëpo vërejmë se prapëseprapë në krahasim me njerëzit tjerë që banonin në të gjitha viset tjera të Hixhazit, këta kishin një standard më të lartë jetese. Mekka nuk mund të furnizohej nga burimet e veta, prandaj ishte e detyruar t’i importonte edhe produktet më të vogla si drithërat, hurmat, pemët, perimet, verën etj. që pa e stërmadhuar Mekkes për çdo kokë banori i nevojiteshin në ditë diku te 100 gr. mall... Duke qenë se Mekka në këtë kohë kishte afro 20-25 mijë banorë, bashkë me të gjitha dymbëdhjetë fiset e “konfederatës” kurejshite, me të besatuarit, me skllëverit e me refugjatët, i bie që Mekka

---

<sup>1</sup> Karen Armstrong, *Muhamedi – një biografi e profetit*, Tiranë 2006, f. 83.

<sup>2</sup> “(Ibrahimi a.s. tha:) *Zoti ynë! Unë një pjesë të familjes sime e vendosa në një luginë, ku nuk ka bimë, e pranë shtëpisë Sate të shenjtë...*” (Kur’ani, Ibrahim:37)

<sup>3</sup> “*All-llahu sjell si shembull një fshat (vendbanim) që ishte i sigurt dhe i qetë, të cilit i vinte furnizimi nga të gjitha anët me bollëk, kurse ata (banorët) i përbuzën të mirat e All-llahut. Atëherë All-llahu, për shkak të sjelljes së tyre, ua veshi petkun e urisë dhe të frikës.*” (Kur’ani, en-Nahl:112); “*Dhe kur Ibrahimi tha: “Zoti im, bëje këtë një qytet sigurie dhe banorët e tij, që besuan All-llahun dhe jetën tjetër, furnizoji me lloje të frutave!” Ai (All-llahu) tha: “Edhe atij që nuk besoi do t’ia mundësoj shfrytëzimin e frutave për një kohë të shkurtër...”*” (Kur’ani, el-Bekara:126)

kishte nevojë për 2-3 tonë furnizim në ditë, respektivisht 20 deve të ngarkuara me mall.”<sup>4</sup>

Në mënyrë që në qytetet e Gadishullit Arabik të asaj kohe të mund të tërhiqeshin sa më shumë të huaj si blerës të mundshëm, ishte ngulitur zakoni i respektimit të muajve të paqes së Zotit. PanaiRET mbaheshin, natyrisht, gjatë kohës së haxhit ose të datave të shenjta fetare. Për shkak të rivalitetit ndërmjet fiseve, secila krahinë respektonte muaj të ndryshëm. Kështu për shembull në muajin rexheb sundonte paqe e plotë në viset ku jetonte fisi Mudar, ndërkaq në muajin ramazan viset e fisit Rebi’ shndërroheshin në strehë për tregtarët e huaj. Në këtë mënyrë sundonte paqja në Gadishullin Arabik: njerëzit e fisit Mudar tregtonin te ata të fisit Rebi’ në muajin ramazan, kurse ata të fisit Rebi’ tregtonin me ata të fisit Mudar gjatë muajit rexheb. Në një pozitë më të lakmueshme ishte trekëndëshi Mekke-Medine-Taif, sepse në këto anë sundonte paqja përgjatë katër muajve, prej të cilëve tre njëri pas tjetrit\*. Kjo ua mundësonte atyre të merrnin edhe rrugë më të gjata për tregti dhe të ktheheshin rehat në shtëpi.<sup>5</sup>

### **Luftërat e *Fixharit***

Megjithëse ekzistonte një farë kompromisi i këtitllë i pashkruar, kohë pas kohe edhe në këta katër muaj që njiheshin si të shenjtë dhe paqësorë, shpërthenin luftëra ndërmjet fiseve të ndryshme edhe atë për arsye banale. Këto pastaj vazhdonin me vite të tëra si pasojë e mendësisë së gjakmarrjes dhe ruajtjes së nderit familjar dhe fisnor. Historia njih katër luftëra të këtitlla të kësaj periudhe. Ato quheshin “luftëra të *fixharit* (mëkatit, shkeljes)”, për shkak të shkeljes dhe prishjes së paqes. Me shumë gjasë Muhammedi a.s. ka marrë pjesë në të katërtën prej këtyre luftërave, si një djalë 20 vjeç, e cila u zhvillua midis fisit Kinaneh dhe Kajs. Një person i shthurur i fisit Kinaneh e kishte vrrarë një person të familjes Amir nga fisi Havazin (Kajs) i Nexhdit. Sipas rendit tanimë standard të hakmarrjes, fisi i viktimës e sulmoi fisin e vrasësit. Meqë fisi Kurejsh ishin në aleancë me fisin Kinaneh, pak si me pa dashje, iu desh të involvohej në këtë luftë, që në fakt s’ishte e vetja. Ky konflikt zgjati tre deri katër vjet, mirëpo aktivisht është zhvilluar luftë vetëm pesë ditë gjatë gjithë kësaj kohe. Roli i Muhammedit a.s. në këtë luftë ishte të mblidhte shigjetat e kundërshtarëve që dilnin huq dhe t’ua ofronte axhallarëve të tij Zubejrit dhe Ebu Talibit, që të mund ata të gjuanin armikun me shigjetat e tyre.<sup>6</sup>

Pas kësaj lufte të fundit të *Fixharit*, në Mekke dhe rrethinë tanimë ishte shembur tej mase siguria e njerëzve. Në veçanti tregtarët e huaj që vinin në Mekke, po edhe të

---

<sup>4</sup> Joseph Chelhod, *Introduction à la sociologie de l’Islam*, Paris, 1958, në Izzet Er, *Din Sosyolojisi*, Ankara 1998, f. 130-131.

\* Këtë do ta përmendë edhe Kur’ani fisnik po edhe Muhammedi a.s. më vonë në një hadith të tij të njohur. Kur’ani thotë: “*Te All-llahu numri i muajve është dymbëdhjetë (sipas hënës), ashtu si është në librin e All-llahut prej ditës kur krijoi qiejt dhe tokën. Prej tyre katër janë të shenjtë...*” (Teube:36), ndërkaq Muhammedi a.s. ka thënë: “*Vërtet koha rrjedh ashtu siç e ka formuar Allahu kur krijoi qiejt dhe tokën. Viti i ka dymbëdhjetë muaj, prej tyre katër janë të shenjtë: tre vijnë njëri pas tjetrit: dhul-ka’de, dhul-hixhe dhe muharrem, kurse muaji rexheb është muaji i fisit Mudar...*” (Buhariu, Muslimi etj.)

<sup>5</sup> Muhammed Hamidullah, *Muhammed a.s. – Život*, vëll. I, Sarajevë 1990, f. 79.

<sup>6</sup> Ibni Hisham, *Siretu’n-Nebijj*, vëll. I, Tanta 1995, f. 180-182; Ibni Sa’d, *Tabekatu’l-kebir*, vëll. I, Kajro 2001, f. 106-7; Hüseyin Algül, *Islam Tarihi*, vëll. I, Stamboll, pa vit botimi, f. 168-169; Martin Lings, *Muhammad – sein Leben nach den frühesten Quellen*, Kandern 2008, f. 49; M. Hamidullah, po aty, f. 79-80.

dobëtit dhe fukarenjtë vendas, gjithnjë u nënshtroheshin shkeljeve dhe dhunës së paparë dhe këta nuk kishin kujt t'i drejtoheshin për mbrojtje dhe rikthim të të drejtave të tyre.<sup>7</sup> Kjo situatë kontribuoi në përhapjen e pakënaqësisë gjithnjë në rritje kundrejt ligjit të shkretëtirës që akoma sundonte te bashkësia e ngulitur mekkase. Shumica e krerëve të fisit Kurejsh tanimë e kishin vizituar disa herë Shamin dhe kishin pasur mundësinë ta përjetonin vetë drejtësinë relative që sundonte në perandorinë romake. Po ashtu edhe në Abisini, të cilën gjithashtu e kishin vizituar disa herë për arsye tregtare, mund ta fitojë të drejtën pa pasur nevojë të zhvillosh ndonjë luftë. Në Arabinë e asaj kohe mungonte një sistem i këtillë i drejtësisë. Prandaj, këto luftëra të Fixharit dhe sidomos situata e pasigurt që u krijua pas kësaj të fundit, i nxiti disa njerëz të mendoheshin mirë se si t'i pengonin këto gjakderdhje, që në të shumtën e rasteve nisnin për arsye fëmijërore. Kësaj radhe kjo nuk mbeti vetëm në mendime dhe fjalë: nga ana e fisit Kurejsh shumica ishin të gatshëm edhe të vepronin. Ky të kuptuar i drejtësisë vetëm disa javë pas luftës së fundit të Fixharit u vu në provë nga një aksident skandaloz që ndodhi në Mekke.

### **Shkaqet e themelimit të *Hilfu'l-fudulit***

Një tregtar nga qyteti bregdetar Zebid i Jemenit i kishte shitur ca mallra të vlefshme një fisniku të Mekkes As bin Vail nga fisi Sehm. Mirëpo ky, duke parë se tregtari ishte i huaj dhe se nuk kishte asnjë aleancë e as ndonjë mbrojtje në Mekke, refuzoi t'ia paguante mallin e blerë. Tregtari nuk u tremb nga ky rast, por guximshëm u ngjiti në kodrinën e Ebu Kubejsit dhe iu drejtua zëshëm fisit Kurejsh për të kërkuar ndihmë prej tyre për ta rikthyer pagesën ose mallin. Shumica e fiseve që nuk kishin aleancë tradicionale me fisin Sehm, reagueshan menjëherë. Fisi Kurejsh dëshironte të ruante unitetin midis fiseve të ndryshme. Një ndër personat më të pasur dhe më me autoritet në Mekken e asaj kohe dhe i pari i fisit Tejm, i quajtur Abdullah bin Xhud'an, e hapi shtëpinë e tij të madhe për të gjithë ata që e donin drejtësinë. Këtu morën pjesë disa fise me nam, ndër ta të përfaqësuar mirë ishin fiset Hashim, Muttalib, Zuhrah, Esed dhe Tejm. Pas një ushqimi të begatë dhe pas një diskutimi të gjatë ata vendosën të krijonin një grup a komitet që do të kujdesej për ruajtjen e rendit, të qetësisë dhe në veçanti mbrojtjen e tregtarëve të huaj dhe të tjerëve që u shkelleshin të drejtat. Ata shkuan pastaj te Qabeja dhe duke lëshuar ujë të rridhte nga Guri i zi i Qabesë e mbushën një enë apo tas me ujë tanimë të bekuar, pinë nga ai ujë dhe me dorën e djathtë të ngritur drejt Qabesë u betuan në All-llahun se "në të ardhmen me rastin e çdo padrejtësie do të qëndronin si një trup gjithnjë në anën e të shkelurit kundër shkelësit, derisa ta marrë i shkeluri hakun e tij, pa marrë parasysh nëse bëhej fjalë për banorë të Mekkes apo për të huaj dhe se kjo do të vazhdonte kështu deri sa të thahej edhe pika e fundit e ujit në det dhe derisa të rrafshoheshin kodrat Hira dhe Thebir". Pastaj shkuan të gjithë së bashku te As bin Vaili dhe kërkuan prej tij t'ia paguante tregtarit jemenas çmimin e pajtuar më parë. Me rëndësi është të përmendet se As bin Vailit me këtë rast nuk i ofruan ndihmë dhe mbrojtje as edhe fiset që nuk morën pjesë në betimin e sipërpërmendur.

Përveç Abdullah bin Xhud'anit, në shtëpinë e të cilit u themelua kjo shoqatë, organizatë a aleancë, ndër më të njohurit dhe më aktivët, madje edhe iniciatori, në këtë punë ishte

---

<sup>7</sup> H. Algül, po aty, f. 170.

Zubejri, axha i Muhammedit a.s., i cili në këtë tubim dhe ceremoni betimi me vete e kishte marrë edhe nipin e tij, pra Muhammedin a.s.. Një tjetër që mori pjesë këtu ishte edhe Ebu Kuhafe nga fisi Tejm, kushëri i nikoqirit, i cili po ashtu me vete e kishte marrë të birin e vet Ebu Bekrin, i cili ishte dy vjet më i ri se Muhammedi a.s. dhe i cili më vonë do të jetë shoku më i ngushtë i Muhammedit a.s..<sup>8</sup> Kjo aleancë në historinë islame njihet me termin *Hilfu'l-fudul* ( حِلْفُ الْفُذُولِ ), që nënkupton “aleanca, pakti, betimi për virtytet ose i të virtytshmëve”. Shumë më herët se ky pakt, në Mekke ishte lidhur edhe një pakt tjetër me emrin *Hilfu'l-Mutajjebin* ( حِلْفُ الْمُطَيِّبِينَ ), që nënkuptonte “betimin e të parfumosurve”, pasi këta me rastin e betimit i kishin futur duart në një enë me ujë të parfumosur. Me këtë betim ishte bërë shpërndarja kryesisht e detyrave midis fisit Benu Abdiddar dhe atij Abdu Menaf si: shërbimi në Qabe, shërbimi me ujë për haxhilerët, bartja e flamurit në luftëra dhe mbrojtja e të dobëtëve në shoqëri.<sup>9</sup>

### **Ndikimet pozitive të *Hilfu'l-Fudulit* përgjatë historisë**

Burimet dhe kronikat më të hershme të historisë islame flasin për ndikimin pozitiv që shkaktoi themelimi i kësaj organizate në shoqërinë e Mekkes dhe më gjerë. Po përmendim disa shembuj:

1. Një jemenas nga fisi Hath'am kishte ardhur për ta kryer umren ose haxhin (sipas riteve të *xhahilijetit* - R.N.) në Mekke bashkë me vajzën e tij. Nubejh bin el-Haxhxhaxhi, një person me nam në Mekke, ia kishte rrëmbyer me zor vajzën tregtarit jemenas. Njerëzit e këshilluan të shkonte te *Hilfu'l-fuduli* dhe të kërkonte ndihmën e tyre. Ai shkoi te anëtarët e këtij komiteti. Ata u mblodhën menjëherë, i ngjeshën shpatat dhe i shkuan Nubejhut te dera duke i kërkuar t'ua dorëzonte vajzën jemenase dhe duke ia bërë me dije se kush ishin ata. Ai u tha se do ta dorëzonte me kusht që së paku një natë të flinte me të. Kur ata e refuzuan rreptësisht këtë kërkesë, ai s'pati çare tjetër pos se ta dorëzonte vajzën.<sup>10</sup>
2. Një person tjetër i huaj nga fisi Thumale i kishte shitur një mall Ubejj bin Halefit, që ishte po ashtu ndër krerët e Mekkes dhe njihej për padrejtësitë që u bënte të dobëtëve. Edhe me këtë rast, ai refuzoi t'ia paguante mallin tregtarit të huaj. Ky shkoi te anëtarët e *Hilfu'l-fudulit* dhe i njoftoi për padrejtësinë që i kishte bërë Umejja. Ata i thanë: “Shko te Umejja dhe thuaji që ne të kemi dërguar tek ai. Nëse ta paguan mallin mirë, nëse jo, eja prapë te ne!” Kur ky shkoi tek Umejja dhe i tregoi se kush e kishte dërguar, Umejja i nxori paratë dhe ia pagoi mallin.<sup>11</sup>
3. Një tregtar po nga fisi jemenas Zebid një herë sjell në Mekke tri deve të ngarkuara me mall. Ebu Xhehli, po ashtu nga krerët e Mekkes së asaj kohe, u mor vesh me blerësit tjerë të mundshëm që të mos ia blinin mallin jemenasit. Duke vepruar kështu dëshironte t'ia ulë çmimin mallit të tregtarit. Tregtari mbeti i habitur nga kjo sjellje.

<sup>8</sup> Ibni Hisham, po aty, f. 180; Ibni Sa'd, po aty, f. 106-7; M. Lings, po aty, f. 50-51; H. Algül, po aty, f. 170.

<sup>9</sup> Ibni Hisham, po aty, f. 177-9.

<sup>10</sup> Es-Suhejli, *Er-Raudu'l-Unuf*, vëll. I, Bejrut p.v., f. 243; Ibnu Habib el-Bagdadi, *El-Munemmak fi ahbari Kurajsh*, Bejrut 1985, f. 55.

<sup>11</sup> Ibnu Habib el-Bagdadi, po aty, f. 54; H. Algül, po aty, f. 171; M. Hamidullah, po aty, f. 81.

Më vonë shkoi te Muhammedi a.s. si një anëtar i *Hilfu'l-fudulit* dhe ia sqaroi rastin. Muhammedi a.s. ia bleu tregtarit të gjithë mallin me çmimin real të tregut, për çka tregtari u gëzua tej mase. Ky rast, nga ana tjetër, njihet si momenti i parë i zënkës së Muhammedit a.s. me Ebu Xhehlin, që do ta përcjellë atë deri në vrasjen e tij në luftën e Bedrit.<sup>12</sup>

4. Përsëri Ebu Xhehli, një herë bleu mall nga një arab i fisit Arash dhe nuk dëshironte t'ia paguante mallin. Tregtari i mërzhitur nga ky rast shkoi pranë Qabesë. Kërkonte dikë t'ia qante hallin. Muhammedi a.s. sapo kishte nisur ta publikonte Islamin dhe Ebu Xhehli njihej si një ndër armiqtë e tij të përбетuar, armiqësi kjo që rrënjët i kishte – siç thamë më lart – qysh në kohën para Islamit. Një banor i Mekkes e drejtoi të shkonte te Muhammedi a.s. Historianët dyshojnë nëse ky mekkasi ishte i sinqertë se vërtet mund t'i ndihmonte Muhammedi a.s. apo, duke e ditur armiqësinë e tyre, dëshironte ta vinte në siklet Muhammedin a.s. Sidoqoftë, tregtari shkoi te Muhammedi a.s. dhe ai reagoi menjëherë. E mori tregtarin me vete dhe shkoi te shtëpia e Ebu Xhehlit, të cilit ia mori paratë e të huajit. Kur morën vesh për këtë miqtë e Ebu Xhehlit, filluan të talleshin me të, si kishte guxuar ai Muhammedi i dobët t'ia merrte paratë. Ai u përgjigj: “Kur Muhammedi trokiti në derë e gjithë shtëpia u dridh sikur të bënte tërmet. Kur e hapa derën, pranë Muhammedit mu përfytyrua një deve e tërbuar që e kishte hapur gojën dhe sikur të isha vonuar në qetësimin e Muhammedit, ajo do të më kishte përpirë të tërin”.<sup>13</sup>
5. Ndikimi i *Hilfu'l-fudulit* vazhdoi edhe në periudhën pas vdekjes së Muhammedit a.s. Historianët rrëfejnë rastin në kohën e Muavijes kur midis valiut (gubernatorit) të Medines, Velid bin Ukbe dhe Husejnit, djalit të hz. Aliut lindi një mosmarrëveshje lidhur me një mall në fshatin Dhulmerve. Velidi, duke u mbështetur në autoritetin e valiut që ishte, dëshiroi t'i bënte presion hz. Husejnit. Me këtë rast ky i fundit i tha: “Të betohem në All-llahun, ose t'i ma jep hakun tim ose e ngjeshi shpatën dhe shkoj pranë Xhamisë së Pejgamberit a.s. dhe i ftoj njerëzit të më ndihmojnë në emër të *Hilfu'l-fudulit*.” Në këto momente aty ndodhej edhe Abdullah bin Zubejri, i cili tha: “Betohem në Zot, se nëse Husejni kërkon ndihmë në emër të *Hilfu'l-fudulit* unë e ngjesh shpatën time dhe luftoj bashkë me të derisa t'i kthehet atij haku ose derisa të vdes bashkë me të”. Kur për këtë situatë marrin vesh edhe Misver bin Mahreme nga fisi Benu Zuhra dhe Abdurrahman bin Uthman i fisit Benu Tejm, i përsërisin edhe këta fjalët e Abdullah bin Zubejrit. Velidi, i shtrënguar nga ky presion shoqëror që u krijua, mbeti t'ia kthente hakun hz. Husejnit dhe t'i kërkonte të falur.<sup>14</sup>

Ky rast tregon ndikimin psikik dhe social të *Hilfu'l-fudulit* që ishte ngulitur në shoqërinë arabe dhe më vonë islame. Edhe pse kjo shoqatë a aleancë me kalimin e kohës u zhbë, nga arsyeja se nuk pranonin anëtarë të rinj në të, prapëseprapë ndikimi psikik dhe social i saj vazhdoi edhe për një kohë të gjatë edhe pas vdekjes së Muhammedit a.s..

---

<sup>12</sup> M. Hamidullah, po aty, f. 81; H. Algül, po aty, f. 171-2.

<sup>13</sup> M. Hamidullah, po aty, f. 81-2; H. Algül, po aty, f. 172.

<sup>14</sup> H. Algül, po aty, f. 172-3.

## Çfarë tha Muhammedi a.s. për këtë aleancë?

Megjithëse ishte i ri, veç 20 vjeç, kur mori pjesë në themelimin e saj, këtë e ruante të freskët në kujtesën e tij jo vetëm si akt themelimi, por edhe rolin dhe funksionin që luajti ajo më vonë. Për këtë arsye, me siguri në periudhën pas hixhretit në Medine, Muhammedi a.s. do të thotë:

شَهِدْتُ غُلَامًا مَعَ عُمُومَتِي حَلَفَ الْمُطَيَّبِينَ (يقصد حلف الفضول)، فَمَا أَحَبُّ أُنِّي لِي حُمَرِ النَّعَمِ وَإِنِّي أَنْكُرُهُ.

*“Si i ri kam qenë bashkë me xhaxhallarët e mi i pranishëm në betimin e “të parfumosurve” (ka pasur për qëllim Hilfu’l-fudulin). Nuk do ta kisha shkelur këtë betim edhe sikur të më jepnin deve të kuqe”.*<sup>15</sup>

Ai po ashtu ka thënë:

لَقَدْ شَهِدْتُ فِي دَارِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ جُدْعَانَ حَلْفًا مَا أَحَبُّ أُنِّي لِي بِهِ حُمَرِ النَّعَمِ وَلَوْ أَدْعَىٰ بِهِ فِي الْإِسْلَامِ لِأَجَبْتُ.

*“Kam qenë dëshmitar i një betimi (aleance) në shtëpinë e Abdullah bin Xhud’anit, të cilën (aleancë) nuk do ta kisha ndërruar edhe me një duzinë devesh të kuqe. Edhe sikur tani në kohën e Islamit të ftohesha në të, do t’i isha përgjigjur ftesës.”*<sup>16</sup>

Në këto dy hadithe shihet qartë qëndrimi jo vetëm pozitiv, por edhe pro-aktiv i Muhammedit a.s. ndaj një aleance, lige, pakti, shoqate a organizate të këtillë. Ai thotë se angazhimin e tij personal në një aktivitet të këtillë nuk do ta kishte zëvendësuar me asgjë, madje thotë: *“Edhe sikur tani në Islam të ftohesha në një besatim a aleancë të tillë, do t’i isha përgjigjur pozitivisht”.*<sup>\*\*</sup>

Këtë fjali të fundit duhet ta analizojmë e studiojmë mirë. Ajo që ndofta na bie në sy të parë është gatishmëria e Muhammedit a.s. për të vepruar dhe qenë aktiv për shoqërinë. Mirëpo, këtu fshihen edhe disa sekrete të tjera që jo çdokujt i bien në sy, e ato janë se Muhammedi a.s. shpreh gatishmërinë për të bashkëpunuar me njerëz që nuk janë muslimanë, sepse kur u lidh *Hilfu’l-fuduli* askush nuk ishte musliman, të gjithë ishin *mushrikë* (politeistë) dhe vetë Muhammedit a.s., që ishte i mbrojtur nga *shirku*/politeizmi, akoma nuk i kishte ardhur Shpallja nga Zoti, dhe këtë angazhim të tij ai nuk e kufizoi vetëm për të mirën e muslimanëve, porse për mbarë shoqërisë.

## Mesazhet e Hilfu’l-fudulit sot

*Hilfu’l-Fuduli* dhe gatishmëria e Muhammedit a.s. për të marrë pjesë sërish në një organizim të tillë përbën bazën e angazhimit të përbashkët të njerëzve me fe e besime të

<sup>15</sup> Ahmed bin Hanbeli, *Musned*, “El-Asheratu’l-mubeshsheratu bi’l-Xhenneh”, 1609.

<sup>16</sup> El-Bejhekiu, *Es-Sunenu’l-Kubra*, “el-Vesaja”, 12 110.

<sup>\*\*</sup> Muhammedi a.s. në një hadith ka thënë: لَا حَلْفَ فِي الْإِسْلَامِ وَإِنَّمَا حَلْفٌ كَانَ فِي الْجَاهِلِيَّةِ لَمْ يَزِدْهُ الْإِسْلَامُ إِلَّا شِدَّةً: *“Nuk ka Hilf (betime) në Islam. Çdo lloj Hilfi që ishte në kohën e xhahilijetit (para Islamit) Islami vetëm se e ka përforcuar”* (Muslimi, *Sahih*, “Fedailu’s-Sahabeh”, 4595). Ibn Haxher el-Askalani si dhe Imam Neveviu thonë që me këtë hadith nuk ndalohen betimet apo paktet, aleancat e këtilla për të mirën e njerëzimit dhe për përforcimin e drejtësisë, porse ndalohen ato që bëhen në emër të së keqes dhe ndalohet trashëgimia midis anëtarëve të këtyre aleancave, siç praktikohesh në kohën para Islamit. (*Fet’hul-Bari* dhe *Sherhu’n-Nevevij*).

ndryshme për të bashkëpunuar në ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave humane. Ky lloj uniteti dhe bashkëveprimi mund të paramendohet në nivele të ndryshme, nga ai lokal tek ai rajonal, nga ai rajonal tek niveli kombëtar madje edhe ndërkombëtar. Është e vërtetë se disa muslimanë që nuk e tolerojnë madje as edhe përshëndetjen për dore të muslimanëve me jo-muslimanët, mund të zhgënjehen nga kjo ide dhe ata mund të dalin kundër kësaj, edhe atë në emër të “ruajtjes” së kauzës “islame”. Mirëpo *Hilfu’l-fuduli* dhe qëndrimi i Muhammedit a.s. ndaj tij edhe pas pejgamberisë, duhet të na shërbejë si mostër se si një bashkim a bashkëpunim i këtillë mund t’i afrojë njerëzit e feve dhe bindjeve ideologjike të ndryshme për të mirën e përbashkët të njerëzimit.

Sot njerëzit anekënd botës – nga vende të ndryshme, nga bindje fetare dhe nga kultura të ndryshme – janë të ndërlidhur ngushtë me njëri-tjetrin, ndoshta si kurrë më parë. Vendet që deri më tani mund të kenë qenë mono-fetare, dalëngadalë po bëhen multi-fetare – dhe kjo po ndodh si në “botën” islame ashtu edhe në “botën” jo-islame. Të dyja këto “bota” tanimë u nënshtrohen njësoj ndikimeve të jashtme fetare dhe kulturore. Kjo po i shkërmoq muret me të cilat ishin të rrethuar për shekuj të tërë. Tanimë nuk shihet si e domosdoshme që një pakicë fetare të asimilohet në shoqërinë shumicë dhe kështu ta humbasë besimin dhe identitetin. Në një atmosferë ku toleranca dhe respekti i ndërsjellë po rritet vazhdimisht, njeriu tanimë mund ta mbajë besimin dhe kulturën e vet dhe në të njëjtën kohë të punojë bashkë me njerëz të besimeve të tjera për të mirën e përbashkët. Vërtet ka disa përjashtime në këtë drejtim, mirëpo këto nuk e prishin rregullin.

Në botën e sotme ka një sërë problemesh të cilat e bëjnë të domosdoshëm një bashkëpunim të këtillë dhe një veprim të unifikuar të njerëzve me besime dhe ideologji të ndryshme. Këtu mund të numërojmë vetëm disa prej tyre: varfëria endemike, ngrohja globale, gara bërthamore, shkretimi ekologjik, imoraliteti i papërmbajtur, kriza në institucionin e familjes, terrorizmi etj. Këto probleme nuk janë specifike vetëm për një bashkësi apo komb. Përkundrazi, ato janë bërë fenomene globale. Ato thjesht nuk mund të zgjidhen në mënyrë efektive pa angazhimin e përbashkët të të gjitha komuniteteve dhe kombeve. Në mungesë të një uniteti dhe bashkëveprimi të këtillë, zor se mund të ndalet gara e njerëzimit drejt shkatërrimit. Disa njerëz mund të mendojnë se një bashkëveprim i këtillë është një ëndërr qesharake, mirëpo ne thjesht nuk kemi zgjedhje tjetër përpos se ta shikojmë këtë ëndërr dhe të mundohemi ta realizojmë atë.<sup>17</sup>

Meqë në Islam drejtësia njihet si një vlerë universale dhe si një e drejtë elementare e të gjitha qenieve njerëzore, pa marrë parasysh racën, fenë, gjininë apo prejardhjet tjera, si e tillë kjo vlerë përbën njërin prej synimeve fundamentale të së drejtës islame. Ibni Kajjimi thotë: “All-llahu xh.sh. e ka bërë të qartë se qëllimi apo synimi (final) në ligjin (*sheriatin*) e Tij është vendosja e drejtësisë dhe e korrektësisë midis njerëzve. Kështu që, cilado rrugë që të çon te drejtësia dhe korrektësia, quhet pjesë e fesë dhe ajo kurrë nuk e kundërshton atë”<sup>18</sup> Krejt ky bashkëveprim natyrisht se bëhet në frymën e shumë ajetëve kur’anore, në veçanti të ajetit 2 të sures el-Maideh:

وَتَعَاوَنُوا عَلَى الْبِرِّ وَالتَّقْوَىٰ وَلَا تَعَاوَنُوا عَلَى الْإِثْمِ وَالْعُدْوَانِ وَاتَّقُوا اللَّهَ ...

<sup>17</sup> Waris Mazhari, “Need for a New Hilf al-Fudul”, në [www.islamicvoice.com](http://www.islamicvoice.com).

<sup>18</sup> Ibni Kajjim el-Xheuzijeh, *Et-Turuk el-Hikmijeh*, 1/13.

*“Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e mosni në mëkate e armiqësi. Kini dro dënimit të All-llahut”.*

Antony T. Sullivan, një njohës i mirë i raporteve të Perëndimit me Lindjen e Mesme, ndaj edhe me botën islame, në trajtesën e tij mbi formën dhe mënyrën e demokratizimit të botës arabe dhe islame, del kundër imponimit të këtij procesi nga ana e SHBA-ve dhe e Perëndimit në përgjithësi me mjete të bezdisshme politike dhe ushtarake. Ai insiston që ky proces në këto vende të mbështetet dhe avancohet sidomos duke e afirmuar traditën dhe kulturën e gjerë e të hershme para-islame dhe islame, e cila përbën një bazë të shëndoshë për ndërtimin e mendimit liberal atje. *Hilfu'l-fudilin* ai e cilëson si **traktatin e parë publik në histori që garanton të drejtat njerëzore**. Ndër të tjera ai thotë: “Në jetën e tij profeti Muhammed ka qenë dëshmitar i një numri të madh të iniciativave për krijimin e një baze ideale mbi të cilat liberalët bashkëkohorë arabë dhe muslimanë mund t’i ndërtojnë institucionet që e mbështesin lirinë. Për shembull, në vitin 590 Muhammedi i ri, plotë 20 vite para se të fillonte t’i shpallehin mesazhet e Kur’anit, ka qenë dëshmitar i ratifikimit të një aleance që quhej *Hilf el-Fudul*. Ky pakt është lidhur në afërsi të Mekkes nga fise të zgjedhura arabe. Kjo aleancë ka qenë traktati i parë publik i këtij lloji që garantonte të drejtat njerëzore. *Hilf el-Fuduli* është një dokument i jashtëzakonshëm”.<sup>19</sup>

Mendimtari bashkëkohor Tarik Ramadan në veprën e tij *“Hapave të Pejgamberit a.s.”* e përmend admirimin që Muhammedi a.s. e ka shprehur ndaj këtij pakti edhe atë vite më vonë pasi kishte nisur t’i shpallej Kur’ani fisnik dhe vetë ky nxjerr këto konkluzë nga ky qëndrim i Muhammedit a.s. ndaj *Hilfu'l-fudulit*: “Pejgamberi a.s. jo vetëm që e ka theksuar veçantinë e kushteve të këtij pakti, i cili i kundërshtonte aleancat e këqija fisnore që mbisundonin në atë kohë, por ai ka shtuar se madje edhe si bartës i mesazhit të Islamit – madje edhe si musliman – ai akoma e pranonte substancën e këtij pakti dhe se nuk do të hezitonte të merrte pjesë sërish në një të tillë. Kjo deklaratë ka një rëndësi të veçantë për muslimanët, dhe më së paku tri mësimë kryesore mund të nxirren nga kjo. Ne kemi parë se Muhammedi a.s. dinte të përfitonte pozitivisht nga e kaluara e tij, mirëpo këtu reflektimi shkon akoma më tej: Muhammedi a.s. e njeh një pakt që ishte lidhur para fillimit të shpalljes (së Kur’anit) dhe i cili pakt zotohej se do ta mbronte drejtësinë në mënyrë të prerë dhe se do ta kundërshtonte shtypjen që ushtrohej mbi të varfrit dhe të dobëtit. Kjo nënkupton faktin se akti i nxjerrjes së këtyre parimeve është bërë para Islamit dhe se këto nuk janë pronë vetëm e Islamit, ngase në fakt Islami dhe mesazhi i tij kanë ardhur ta konfirmojnë substancën (thelbin) e një kontrate të cilën vetëdija njerëzore tanimë e kishte formuluar në mënyrë të pavarur. Këtu, Pejgamberi a.s. qartë e njeh vlefshmërinë e parimit të drejtësisë dhe mbrojtjen e të shtypurit, të përcaktuar në një pakt të kohës para-islame.

Mësimi i dytë nuk është më pak esencial: në një kohë kur mesazhi zhvillohej dhe shtjellohej akoma gjatë shpalljes së Kur’anit dhe përvojës së Muhammedit a.s., ai e njohu vlefshmërinë e një pakti të lidhur nga jo-muslimanët që kërkonte drejtësinë dhe të mirën e përbashkët të shoqërisë së tyre. Deklarata e Pejgamberit a.s. në vetvete është një refuzim i zëshëm i prirjes së mendimeve që janë shprehur herë pas here përgjatë historisë së mendimit islam – madje edhe sot e kësaj dite – sipas së cilës një zotim a

---

<sup>19</sup> Antony T. Sullivan, “Islam, America, and the political economy of liberty” në [www.thefreelibrary.com](http://www.thefreelibrary.com).

aleancë mund të jetë e vlefshme për muslimanët vetëm nëse ka një natyrë të pastër islame ose/dhe nëse është lidhur midis muslimanëve. Po e themi përsëri, pika kyç është se Pejgamberi a.s. qartë e njeh vlefshmërinë e respektimit të parimeve të drejtësisë dhe të mbrojtjes së të shtypurve, pa marrë parasysh se nga vijnë këto parime, nga brenda Islamit ose prej jashtë tij.

Mësimi i tretë është një rezultat i drejtpërdrejtë i këtij reflektimi: mesazhi i Islamit në asnjë mënyrë nuk është një sistem i mbyllur vlerash që bie ndesh me sistemet tjera të vlerave. Që nga fillimi, Pejgamberi a.s. nuk e konceptoi përmbajtjen e këtij mesazhi si shprehje të një diçkaje krejt tjetër kundrejt asaj që e prodhuan arabët ose shoqëritë tjera në kohën e tij. Islami nuk krijon një univers të mbyllur të referimit, përkundrazi mbështetet në një sërë parimesh universale që mund të përkujtojnë me bazat dhe vlerat e besimeve dhe traditave të tjera fetare (madje të krijuara edhe nga një shoqëri politeiste, siç ishte ajo e Mekkes në atë kohë). Islami është një mesazh i drejtësisë që shkakton rezistencën ndaj shtypjes dhe mbrojtjes së dinjitetit të të shtypurit dhe të varfrit, andaj muslimanët duhet ta njohin vlerën morale të një ligji a të një kontrate që e kushtëzon këtë kërkesë, pa marrë parasysh se kush janë autorët dhe pa marrë parasysh se çfarë shoqërie e prodhon këtë, shoqëri islame apo jo-islame. Larg ndërtimit të një bindjeje ndaj Islamit në të cilën njohja dhe lojaliteti janë ekskluzive për komunitetin fetar, Pejgamberi a.s. është përpjekur ta zhvillojë ndërgjegjen e besimtarëve përmes ndjekjes së parimeve që i tejkalojnë besnikëritë e mbyllura, pra që mbështeten në lojalitetin primar ndaj vetë parimeve universale. Mesazhi i fundit nuk i sjell asgjë të re afirmimit të parimeve të dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe barazisë: ai thjesht i rikujton dhe i konfirmon ato. Jo vetëm te vlerat morale, por këtë intuitë e shohim edhe atëherë kur Pejgamberi a.s. flet për cilësitë e individëve para dhe në Islam: “*Më të mirët prej jush [kur janë në pyetje cilësitë njerëzore dhe morale] gjatë kohës para Islamit [xhahilijetit] janë edhe më të mirët në Islam, nëse ata e kuptojnë atë [Islamin]*”.<sup>20</sup> Vlera morale e një qenieje njerëzore e tejkalon përkatësinë ndaj një bote të caktuar të referimit; brenda Islamit ajo kërkon njohuri dhe kuptim shtesë në mënyrë që ta rrokë tamam atë që e konfirmon Islami (parimin e drejtësisë) dhe atë që e kërkon të reformohet (të gjitha llojet e adhurimit të idhujve).<sup>21</sup>

Thënë shkurt, T. Ramadani nxjerr tri parime nga *Hilfu'l-fuduli*:

1. Islami i përqafton vlerat e nxjerra nga ndërgjegjja njerëzore, qoftë të vijnë këto edhe nga një traditë tjetër fetare jashtë Islamit. Kjo nga arsyeja se Muhammedi a.s. e njohu një pakt të themeluar para Islamit.
2. Islami e njeh drejtësinë e jo-muslimanëve. Në rastin e *Hilfu'l-fudulit* jo-muslimanët (mushrikë, politeistë madje) e kanë mbrojtur drejtësinë dhe të shtypurit.
3. Islami, në vend që të ndërtojë besnikërinë ndaj një bashkësie të mbyllur, kërkon besnikërinë ndaj parimeve universale. Mesazhi i Islamit nuk është një sistem i mbyllur vlerash, e as që është në kundërshtim a konflikt me sistemet tjera të vlerave.

---

<sup>20</sup> Këtë hadith e përmend Ibni Hibbani në *Raudatu'l-Ukala'*: حَيَاتُكُمْ فِي الْجَاهِلِيَّةِ حَيَاتُكُمْ فِي الْإِسْلَامِ إِذَا فَهَمُوا

<sup>21</sup> Tariq Ramadan, *In the Footsteps of the Prophet – Lessons from the Life of Muhammad*, Nju Jork 2007, f. 21-2.

## Përmyllje

Sado që një shoqëri të jetë e shthurur dhe e çorientuar, aty sërish dhe domosdo gjenden elemente që i mbrojnë, i kultivojnë dhe u dalin zot vlerave universale si drejtësia, korrektësia, ndershmëria, mos-mashtrimi, mos-shtypja etj. Bashkëpunimi i muslimanëve me elementë që u dalin zot këtyre vlerave jo vetëm që është e lejuar nga aspekti islam, por për më tepër, përbën thelbin e mesazhit të Islamit, e me këtë kjo shihet edhe si imperativ i domosdoshëm në ngritjen e një shoqërie të shëndoshë.

Le të na shërbejë shembulli i *Hilfu'l-fudulit* sidomos ne muslimanëve që jetojmë në Perëndim që të participojmë në shoqëri, të marrim pjesë në ngritjen dhe ruajtjen e vlerave universale, vazhdimisht duke mbetur musliman.

Përkryerja e identitetit musliman nënkupton shprehjen dhe manifestimin e besimit përmes sjelljes së arsyeshme. Të jesh musliman do të thotë të vepros në përputhje me mësimet islame pa marrë parasysh mjedisin dhe s'ka asgjë në Islam që e shtyn muslimanin ta largojë nga shoqëria në mënyrë që të jetë më afër me Zotin. Është në fakt e kundërta, "realizimi i besimit" në Kur'an ndërlidhet me mirësjelljen, me "bimirësinë".<sup>22</sup> Pejgamberi a.s. vazhdimisht e ka theksuar këtë dimension të identitetit musliman. "**Më i dashuri te Allahu është ai që është më i dobishmi për njerëzit**".<sup>23</sup>

Besimin individit duhet ta shprehë përmes veprimeve koherente. Ai mund të veprojë para Zotit, por kjo nuk i mjafton, ai e ka për detyrë të përpiqet të përzihet me njerëzit, gjë e cila e shpreh qartë idenë e komunikimit me të tjerët, të bashkëveprimit me bashkëqytetarët. Duket qartë se përkufizimi i identitetit musliman është i hapur, dinamik, i bazuar në parime, por në ndërveprim të vazhdueshëm me mjedisin ku jeton.

---

<sup>22</sup> Tarik Ramadan, *Të jesh mysliman evropian*, Shkup 2011, f. 281-283.

<sup>23</sup> Taberaniu, Bejhekiu etj.: أَحَبُّ النَّاسِ إِلَى اللَّهِ أَنْفَعُهُمْ لِلنَّاسِ